

VENDIM
Nr.465, datë 29.06.2006

PËR MOSDHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT
“GOLD”

PERSONIT FIZIK: z. ZAMIR SPATHARA

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim rtv analogjik tokësor në nivel vendor” të miratuar me vendimin nr.355, datë 29.08.2005 të KKRT-së, të vendimit nr.444, datë 21.03.2006 të KKRT-së “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radio e televizivë”, si dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin e KKRT-së nr.375, datë 30.11.2005, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. Të mos i japë licencë subjektit fizik, z.Zamir Spathara për televizionin vendor privat “GOLD”, pasi në dokumentacionin e paraqitur mungon:

- kapitali themeltar i shoqërisë është paraqitur në formë të aseteve sipas raport vlerësimit për asete që janë jashtë veprimtarisë rtv (në kundërshtim me nenin 20 të ligjit nr.8410).

2. Subjekti sipas pikës 1 të vendimit, mund të ankohet në Gjykatën e Shkallës Parë Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Halil Lalaj